



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 20 Datë 10. 04. 2017

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “MARINA/M” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pikës 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim të subjektit “**MARINA/M**”, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**MARINA/M**” SH.P.K., me administrator Z.Ylli STERKAJ, për përdorim të burimit ujor **Lumi Cemit,** për prodhim energjie elektrike në Fshatin Selcë,Njësia Administrative Kelmend, Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC OSTRIC do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës marrjes X – 43 87 266.6; Y – 47 10 987; Z – +677m;

Koordinatat e godinës së centralit: X – 43 86 804.8; Y – 47 10 077.6; Z - +615m:

Koordinatat e pikës së shkarkimit: X – 43 86 804.8; Y – 47 10 077.6; Z - +615m

Prurja mesatare vjetore e burimit : Q mes= 1.96 m³/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Qllog = 2.5 m³/sek;

Prurja ekologjike: Qekol= 0.21m³/sek;

Prurja që shkarkohet: Q= 2.5 m³/sek.

2- Autorizimi i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e ketij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË
SEKRETAR
Martin PLLUMBI



KRYETAR
Paulin RADOVANI